



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1396/ 8 prot.

Datë 18 .06.2026

V E N D I M
Nr. 828 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18 .06.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “Anbim ” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81911-04-15-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 1,365,403.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Marketing Distribution” shpk me NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë -Durrës km 10.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vau Dejës, me adresë: Rruga ”Qafa e Gurit”, Vau Dejes

Subjekti i interesuar: Operatori ekonomik “Anbim ”shpk, NIPT: M01809026H Adresa: Rruga Muhamet Gjollësja, Pallati 30, Shk.3, Ap.20 Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është “E hapur e thjeshtuar”, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik të ndryshuara.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81911-04-15-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 1,365,403.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejes.

II.2 Në datën 28.04.2026 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1.“ANBIM” SHPK” SHPK	1.200.235	lekë	kualifikuar
2.“ATLANTIK 3 SHPK	1.218.850	lekë	Skualifikuar
3.“MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK	1.230.000	lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 05.05.2026 Autoriteti Kontraktor ka publikuar njoftim fituesin paraprak procedurën objekt ankimi në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.).

II.4. Në datën 06.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.1396/2026 protokoll, dhe protokolluar pranë KPP, datë 06.05.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6625, e operatorit ekonomik “Marketing Distribution” SHPK, me anë të së cilës ngrihen pretendime lidhur me operatorin ekonomik “Anbim” shpk.

II.5 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1396/1 prot., datë 07.05.2026, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.6 Më datë 01.06.2026, Komisioni i Prokurimit publik i është drejtuar autoritetit kontraktor , me shkresën me nr. 1396/3 prot., datë 01.06.2026, më lëndë: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Marketing Distribution” sh.p.k”.

II.7. Më datë 02.06.2026 nga autoriteti kontraktor , është protokolluar shkresa me nr.1396/4, datë 01.06.2027, me objekt “ *Informacion* ”, në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues, për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton se nuk është pranuar. Informacion i ardhur dhe nëpërmjet shkresës me nr. 1396/5 datë 08.06.2026 protokolluar me tonën.

II.8. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ Anbim ”, shpk, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing Distribution ” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik me arsyën se ...[Në shtojcën 7 të Dokumenteve Standarte të Tenderit në pikën 2.4.2 është kërkuar: “2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertes mostra per artikujt 1,2,4,27,32,33 dhe këto produkte duhet të jenë të pajisura me Skdat Teknike, Çertifikatën e Sigurisë, Çertifikatën e Cilësisë nga Prodhuesi, Çertifikatën e Konformitetit CE Mostrat duhet të jenë në amballazhet origjinale dhe ne përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe të paraqitura në oferten teknike. Mosparaqitja e mostrave, dorazi, në ditën e hapjes së ofertave është kusht skualifikues” Në lidhje me kriterin e lartpërmendur, pretendojmë që ky ofertues nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë për të gjitha mostrat e kërkuara në këtë kriter dokumentacionin provues

Skedat Teknike, Çertifikatën e Sigurisë, Çertifikatën e Cilësisë nga Prodhuesi, Çertifikatën e Konformitetit CE. Pretendojmë që skedat e dorëzuara nga ana e tij nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Përsa më sipër vendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, duke kualifikuar si ofertues të parë, shoqërinë “Anbim” është vendim i marrë në kundërshtim me ligjin e prokurimeve dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij Në lidhje me vlerësimin e bërë nga ana e KVO-së për ofertuesit “Atlantik” jemi dakort me vendimin e KVO-së...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit ka parashikuar kriterin në pikën 2.4.2 shtojca 8, si dhe shtojcën nr. 7, si në vijim :

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertës mostra per artikujt 1,2,4,27,32,33 dhe këto produkte duhet të jenë të pajisura me Skedat Teknike, Çertifikatën e Sigurisë, Çertifikatën e Cilësisë nga Prodhuesi, Çertifikatën e Konformitetit CE Mostrat duhet të jenë në ambalazhet origjinale dhe në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe të paraqitura në ofertën teknike. Mosparaqitja e mostrave, dorazi ,në ditën e hapjes së ofertave është kusht skualifikues.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
 - Mostrat duhet të paraqiten për artikujt objekt i këtij prokurimi
 - Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër të kryerje shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Solucion larës dysHEMEJE(PLLAKASH) (1 liter)	cope	450
2	Solucion larës XHAMASH (750 ml)	cope	350
3	Sapun i lëNGSHËM (500 ml)	cope	300

4	Acid për pastrim (1 liter)	cope	385
5	Solucion larës EC dezinfektues (1 liter)	cope	360
6	Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitariet me mekanizëm sprucimi (1liter)	cope	85
7	Solucion larës enësh lëng (1 liter)	Cope	60
8	Solucion për zhbllokim lavamani (1 liter)	Cope	120
9	Aromatik për zyra (300 ml)	Cope	120
10	Shkopa inoksi	Cope	100
11	Shtupë për larje dysHEMEJE	Cope	160
12	Lecka për larje xhamash (përmasa 32 x 32 cm)	cope	135
13	Peceta pluhrash të thjeshta (3 fije/pako)	pako	143
14	Peceta pastrimi mikrofibrë (3 fije/pako)	pako	140
15	Fshesë me sfungjer dhe gomë për pastrimin e xhamave	Cope	70
16	Sfungjer për pastrim hidrosanitairesh	Cope	205
17	Doreza gome	pale	150
18	Doreza Latex ose Nitrile	pako	85
19	Fshesë pastrimi pa bisht	Cope	160
20	Furça për pastrimin e EC-së	Cope	120
21	Furce pastrimi lavamani	Cope	70
22	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik	Cope	80
23	Kovë pastrimi e thjeshtë për shtupë (5 litër)	Cope	50
24	Kosh plastik për hedhjen e mbeturinave (30 litër)	Cope	25
25	Letër duarsh me kuti (250 fije)	Pako	70
26	Letër guzhine e paketuar (10m)	Rulon	58
27	Letër higjenike e paketuar (min 10 rulon/paketim)	Pako	260
28	Qese mbeturinash (35 litër)	Pako	375
29	Tel enesh	Pako	30
30	Detergjent kundër yndyrnave (1 l)	cope	40
31	Detergjent kundër njollave (sgrasatore)(750 ml)	cope	50
32	Pluhur larës lavatriçe për rroba të bardha	kg	280
33	Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë	kg	550
34	Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash (5 l)	cope	100
35	Alkool etilik 70 % (1liter)	liter	110
36	Shampo për larje koke (500 ml)	Cope	70
37	Shampo për larje trupi (500 ml)	Cope	70
38	Sapun rrobash (100 gram)	Cope	100
39	Kosha tualeti me pedale (3 Litër)	cope	63
40	Mbulesë tavoline letre (përmasa 1x1)	cope	200

Afatet e lëvrim:

20 dite nga nenshkrimi i kontrates.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- ISO 9001:2015 NR I1584604960Q, SKEDA TEKNIKE, SOLUCION LARES DYSHEMEJE (PLLAKASH);
- ANBIM shpk NIPT L81618008J ISO 9001:2015, NR I1584604960Q, SKEDA TEKNIKE DETERGENT PER Xhama;
- ISO 9001:2015 NR I1584604960Q SKEDA TEKNIKE Solucion Acid Klorhidrik;
- ANBIM shpk NIPT L81618008J ISO 9001:2015 NR I1584604960Q SKEDA TEKNIKE DETERGENT Pluhur per Lavatrice RROBA TE BARDHA;
- ANBIM shpk NIPT L81618008J ISO 9001:2015 NR I1584604960Q SKEDA TEKNIKE DETERGENT Pluhur per Lavatrice RROBA ME NGJYRA;
-

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të 15 zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti

kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të 16 lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar

vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.7. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Marketing Distribution” shpk si dhe referuar shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik “Anbim” shpk në përmbushje të kriterit 2.4.2 rezulton se nga verifikimi i dokumentacionit të kryer nga ana e Komisionit, të cituar më lartë në këtë vendim, pika III.1.2, operatori “Anbim” shpk ka ngarkuar në sistem dokumentacionin si në vijim: ISO 9001:2015 NR I1584604960Q, SKEDA TEKNIKE, SOLUCION LARES DYSHEMEJE (PLLAKASH);

- ANBIM shpk NIPT L81618008J ISO 9001:2015, NR I1584604960Q, SKEDA TEKNIKE DETERGENT PER Xhama;
- ISO 9001:2015 NR I1584604960Q SKEDA TEKNIKE Solucion Acid Klorhidrik;
- ANBIM shpk NIPT L81618008J ISO 9001:2015 NR I1584604960Q SKEDA TEKNIKE DETERGENT Pluhur per Lavatrice RROBA TE BARDHA;

-ANBIM shpk NIPT L81618008J ISO 9001:2015 NR I1584604960Q SKEDA TEKNIKE DETERGENT Pluhur per Lavatrice RROBA ME NGJYRA , në këto kushte KPP konstaton se referuar kriterit të kërkuar në pikën 2.4.2 të DT, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar se 2.4.2 *Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertës mostra per artikujt 1,2,4,27,32,33 dhe këto produkte duhet të jenë të pajisura me Skedat Teknike, Çertifikatën e Sigurisë, Çertifikatën e Cilësisë nga Prodhuesi, Çertifikatën e Konformitetit CE Mostrat duhet të jenë në amballazhet origjinale dhe ne përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe të paraqitura në ofertën teknike. Mosparaqitja e mostrave, dorazi ,në ditën e hapjes së ofertave është kusht skualifikues.*

Nga verifikimi i dokumenatacionit rezulton se, nga dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik nuk rezulton skeda për artikullin me nr. 27 “*Letër higjenike e pakeluar (min 10 rulon/paketim)*”, sikurse është kërkuar në pikën 2.4.2 për artikujt 1,2,4,27,32,33 nga autoriteti kontraktor.

Pra në këto kushte rezulton se operatori ekonomik anbim nuk ka plotësuar kriterin e parashikuar në pikën 2.4.2 të dokumentave standarte të tenderit.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

-Lidhur me , “Çertifikatën e Sigurisë” për artikujt 1,2,4,27,32,33, Komisioni pasi kreu verifikimet në sistemin elektronik rezulton se operatori ekonomik “Anbim” shpk ka ngarkuar në sistemi dokumentacionin “Çertifikatë e Sigurisë” për artikuj me nr. 1. *Solucion larës dysHEMEJE(pllakash) (1 liter)*;2. *Solucion larës xhamash (750 ml)*;4.*Acid për pastrim (1 lit)*;32. *Pluhur larës lavatrice për rroba të bardha*;33. *Pluhur larës lavatrice për rroba me ngjyrë* .

Lidhur me pretendimin mbi “Çertifikatën e Sigurisë” për artikujt 1,2,4,27,32,33, Komisioni prokurimit publik, pasi kreu verifikimet ne sistemin elektronik per dokumentacionin e kërkuar në kriterin 2.4.2 të shtojcës 8 pjesë e dokumentave standarte, rezulton se, për artikullin me nr. 27 “*Letër higjenike e pakeluar*

(min 10 rulon/paketim)”, mungon “Çertifikata e Sigurisë”, sikurse është kërkuar në pikën 2.4.2 për artikujt 1,2,4,27,32,33 nga autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

-Lidhur me , “Çertifikatën e Konformitetit”, për artikujt 1,2,4,27,32,33, Komisioni pasi kreu verifikimet në sistemin elektronik rezulton se operatori ekonomik “Anbim” shpik ka ngarkuar në sistemin dokumentacionin “Çertifikatën e Konformitetit”, për artikuj me nr. 1. *Solucion larës dysHEMEJE(pllakash) (1 liter);2. Solucion larës xhamash (750 ml);4.Acid për pastrim (1 lit);32. Pluhur larës lavatriçe për rroba të bardha;33. Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë* , më të dhënat si në vijim:

-Certifikate Konformiteti SOLUCION PER PASTRIMIN E DYSHEMEVE EMRI PRODUKTI BRIL

-Certifikate Konformiteti Solucion Acid Klorhidrik

-Certifikate Konformiteti DETERGENT SOLUCION PER LARJE XHAMASH EPTA XHAM

-Certifikate Konformiteti DETERGENT Pluhur per Lavatrice RROBA TE BARDHA

-Certifikate Konformiteti DETERGENT Pluhur per Lavatrice RROBA ME NGJYRA

Komisioni prokurimit publik, lidhur me pretendimin mbi “Çertifikatën e Konformitetit” për artikujt 1,2,4,27,32,33, pasi kreu verifikimet në sistemin elektronik rezulton se, për artikullin me nr. 27 “*Letër higjienike e paketuara (min 10 rulon/paketim)*”, mungon “Çertifikatën e Konformitetit”, sikurse është kërkuar në pikën 2.4.2 për artikujt 1,2,4,27,32,33 nga autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Marketing Distribution” SHPK për skualifikimin e nga procedura e prokurimit të operatorit ekonomi “ANBIM”SHPK, ato nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi në procesin e shqyrtimit administrativ pasi gjendja juridike dhe faktike e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK, do të kalojë nga “i kualifikuar” në “i skualifikuar” dhe për sa sa kohë qëllimi i operatorit ekonomik ankimues realizohet.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranoj pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Marketing Distribution” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81911-04-15-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 1,365,403.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 27-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit duke skualifikuar operatorin ekonomik “Anbim” SHPK në përputhje me konstatimet e mësipërme.
 3. Autoriteti kontraktor të vërë në dijeni Komisionin e prokurimit publik, brenda 5 ditëve, duke dokumentuar vepimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” sh.p.k.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

